



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Drejtoria për Zhvillimit Rural

THIRRJE PËR APLIKIM TË FERMERËVE PËR PÛRKRAHJËN E PRODHUESVE TË QUMËSHITIT 2024

Ftojme fermeret e Komunës së Prishtinës të aplikojnë për subvencione, pagesa direkte, për prodhim të qumështit 2024.

Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:

- Të jenë banorë të komunës së Prishtinës dhe aktivitetin e tyre prodhues ta realizojnë në territorin e komunës së Prishtinës;
- Të ofrojnë dëshmi të lëshuar nga laboratorit i AUV-së për cilësinë e qumështit, të dorëzuar në qumështore të licencuara ose në ndonjëren nga pikat e grumbullimit të qumështit si biznese, të cilat kanë kontratë me ndonjëren qumështoret e licencuara;
- Të kenë kontratë të vërtetuar nga noteri, për shitjen e qumështit në ndonjëren nga qumështoret e licencuara ose në ndonjëren nga pikat e grumbullimit të qumështit si biznese, të cilat kanë kontratë me ndonjëren qumështore të licencuar;
- Të ofrojnë dëshmi bankare për sasinë mujore të qumështit të shitur;
- Të kenë dorëzuar së paku 1,000 (një mijë) litra qumësht dhe më së shumti deri në 20,000 (njëzet mijë) litra qumësht për 6 (gjashtë) muaj;
- Subvencionimi do të bëhet për litër qumësht të dorëzuar, brenda kornizave prej më së paku 1,000 deri 20,000 litra.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e një dokumenti identifikues valid i Republikës së Kosovës;
- Konfirmimi nga banka për xhironlogarinë bankare;
- Kopja e listës së verifikimit të kafshëve: gjedhet, dhentë dhe dhitë, të lëshuar nga Sektori për identifikim dhe regjistrim në kuadër të AUV-së;
- Kopja e kontratës, e vërtetuar nga noteri, për furnizim me qumësht, të lëshuar nga qumështoret e licencuara ose në ndonjëra nga pikat e grumbullimit të qumështit si biznese, të cilat kanë kontratë me ndonjëren qumështore të licencuar;
- Dëshmia për sasinë e qumështit të dorëzuar në qumështore ose pikën grumbulluese të qumështit;
- Dëshmia nga banka për sasinë e qumështit të shitur;
- Dëshmia për pjesëmarrjen në projektin "Transparenca dhe neutraliteti i marrjes së mostrave të qumështit" (e lëshuar nga projekti).

Afati i aplikimit është nga 21/08/2024 deri 30/08/2024, në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës.